

Fleta e të dhënave të produktit
Botimi 27/10/2015
Nr. i identifikimit: 010707030010000004
Kodi: 09.04.020
Sikadur®-52 Injection



EN 1504-5:2005

09

0099

Sikadur®-52 Injection

Rrëshirë injektimi me viskozitet të ulët

Përshkrimi i produktit

Sikadur®-52 Injection Lloji N dhe Lloji LP janë lëngje për injektim, prej 2 përbërësish, pa tretës, viskozitet të ulët dhe me bazë rrëshirash epokside me rezistencë të lartë.

Lloji N (= kohë normale punueshmërie) përdoret për temperatura nënshtrese midis +5°C dhe +30°C.

Lloji LP (=kohë e gjatë punueshmërie) përdoret për temperatura nënshtrese midis +25°C dhe +40°C.

Përdorime

Si një rrëshirë injektimi me ndërkapje të mire në beton, llaç, gur, çelik dhe dru. Sikadur®-52 Injection Lloji N dhe Lloji LP përdoren për të mbushur dhe izoluar vrimat dhe plasaritjet në struktura si urat dhe ndërtesa të tjera të inxhinierisë civile, ndërtesa industriale dhe banimi, p.sh. kolona, traversa, themele, mure, dysheme dhe strukturat që mbajnë ujë. Jo vetëm që formon një pengesë efektive ndaj depërtimit të ujit dhe faktorëve nxitës të korrodimit, por gjithashtu lidh strukturalisht betonin me pjesët e tjera.

Karakteristika / Avantazhe

- Pa tretës
- E përshtatshme për të dyja kushtet, të thata dhe me lagështi
- E përdorëshme në temperatura të ulëta
- Dy lloje për kushte të ndryshme klimatike (kohë punueshmërie normale dhe e gjatë)
- Forcim pa tkurrje
- Rezistencë e lartë mekanike dhe ngjitjeje
- E forte por jo e thyeshme
- Viskozitet i ulët
- E injektueshme me pompë një komponentëshe

Testime

Miratime / Standarde

Rrëshirë injektimi prej 2 përbërësish për elemente betoni, sipas EN 1504-5, Parimi 4, Metoda 4.5 dhe 4.6. Përputhet me Aneksin ZA, Tabela ZA.1

DoP 01 03 02 06 002 0 000004 1053, certifikuar nga Organi i Kontrollit të Prodhimit në Fabrikë, 0099 dhe pajisur me shenjën CE.

Construction



Të dhënat e produktit

Forma

Ngjyra	Përbërësi A: i tejdukshëm Përbërësi B: kafe Përbërësit A+B të përzierë: e verdhë në kafe
---------------	--

Ambalazhi	I paketuar: Përbërësit A+B: 10 x 1 kg njësi Rifuxho: Me porosi
------------------	---

Magazinimi

Kushtet e magazinimit / Jetëgjatësia	24 muaj nga data e prodhimit nëse magazinohet saktë në ambalazhin original, të pahapur, të padëmtuar dhe të vulosur në kushte të thata dhe temperatura midis +5°C dhe +30°C.
---	--

Të dhëna teknike

Baza kimike	Rrëshirë epokside prej 2 përbërësish e modifikuar pa tretës.
--------------------	--

Dendësia	Përbërësit A+B të përzierë (2 : 1): 1.1 kg/l (në +20°C)
-----------------	---

Viskoziteti

Temperatura	Lloji normal përbërësit A+B të përzierë (2 : 1)	Lloji me kohë punueshmërie të gjatë përbërësit A+B të përzierë (2 : 1)
+10°C	~ 1200 mPa·s	-
+20°C	~ 430 mPa·s	~ 330 mPa·s
+30°C	~ 220 mPa·s	~ 150 mPa·s
+40°C	-	~ 95 mPa·s

Koeficienti i zgjerimit termik	<i>Lloji normal:</i> 8.9 x 10 ⁻⁵ për °C (nga -20°C në +40°C) (Sipas EN ISO 1770) <i>Lloji me kohë punueshmërie të gjatë:</i> 9.4 x 10 ⁻⁵ për °C (nga -20°C në +40°C) (Sipas EN ISO 1770)
---------------------------------------	---

Vetitë mekanike / fizike

Rezistenca ndaj ngjeshjes	<i>Lloji normal:</i> 52 N/mm ² (pas 7 ditësh në +23°C) (Sipas ASTM D695-96) <i>Lloji me kohë punueshmërie të gjatë:</i> 34 N/mm ² (pas 7 ditësh në +30°C) (Sipas ASTM D695-96)
----------------------------------	---

Rezistenca ndaj përkuljes	<i>Lloji normal:</i> 61 N/mm ² (pas 7 ditësh në +23°C) (Sipas DIN 53452) <i>Lloji me kohë punueshmërie të gjatë:</i> 41 N/mm ² (pas 7 ditësh në +30°C) (Sipas DIN 53452)
----------------------------------	---

Rezistenca ndaj tërheqjes	<i>Lloji normal:</i> 37 N/mm ² (pas 7 ditësh në +23°C) (Sipas ISO 527) <i>Lloji me kohë punueshmërie të gjatë:</i> 24 N/mm ² (pas 7 ditësh në +30°C) (Sipas ISO 527)
----------------------------------	---

Fuqia e ngjites	Në beton: (Sipas DafStb-Richtlinie, pjesa 3) > 4 N/mm ² (dështim në beton) (pas 7 ditësh në +23°C)
------------------------	--

Moduli i elasticitetit	Rezistenca ndaj përkuljes: <i>Lloji normal:</i> 1800 N/mm ² (pas 7 ditësh në +23°C) (Sipas DIN 53 452) <i>Lloji me kohë punueshmërie të gjatë:</i> 1100 N/mm ² (pas 7 ditësh në +30°C) (Sipas DIN 53 452)
-------------------------------	---

Informacione mbi sistemin

Detaje aplikimi

Konsumimi / Rendimenti	1 kg Sikadur [®] -52 Injection Lloji N dhe Lloji LP janë ~ të barabarta me 1 l rrëshirë injektimi.
Përgatitja e nënshtresës	Kërkesat: E qëndrueshme, e pastër, pa vaj dhe graso, pa veshje të vjetra dhe trajtime sipërfaqesh etj. Trajtim paraprak për ngjitje të mirë: Betoni, llaçi, guri duhet të përgatiten tërësisht me rrymë uji në presion të lartë ose me pajisje mekanike si bluarja, gdhëndja e metalit etj. Plasaritjet duhet të pastrohen me kompresor ajri për të hequr pluhurin.

Kushtet e aplikimit / Kufizime

Temperatura e nënshtresës	<i>Lloji normal:</i> +5°C min. / +30°C max. <i>Lloji me kohë punueshmërie të gjatë:</i> +25°C min. / +40°C max.
Përmbajtja e lagështisë së nënshtresës	E thatë ose e lagësht (SSD - Saturated Surface Dry, tharje e ngopur e sipërfaqes: pa ujë të grumbulluar)

Udhëzime aplikimi

Përzierja	<i>Lloji normal dhe me kohë punueshmërie të gjatë:</i> Raporti i përzierjes A : B = 2 : 1 pjesë të peshës dhe vëllimit
Koha e përzierjes	Ambalazhi i gatshëm: Shtoni të gjithë përbërësin B tek përbërësi A. Përzieni me përzierës elektrik në shpejtësi të ulët (max. 250 rpm) për të paktën 3 minuta. Shmangni bllokimin e ajrit. Rifuxho: Shtoni të dy përbërësit në proporcionin e saktë në një enë të pastër dhe të thatë dhe përzieni në të njëjtën mënyrë si ambalazhet e gatshme.
Metoda e aplikimit / Mjetet	Plasaritje në pllaka horizontale: Mbushni disa here me furçë ose me anën e forcës së rëndesës duke derdhur përzierjen Sikadur [®] -52 Injection Llojin N dhe Llojin LP midis vendit të mbyllur e të kufizuar që formohet p.sh. nga vulosësi Sikaflex [®] . Plasaritjet të cilat depërtojnë pllakën deri tek pjesa e poshtme e saj duhet që më parë të izoloohen p.sh. me llaçin epoksid Sikadur [®] -31 ose me ndonjë llaç të përshtatshëm çimentoje Sika. Plasaritjet në struktura vertikale: Sikadur [®] -52 Injection Lloji N dhe Lloji LP mund të injektohen me presion brenda plasaritjeve duke përdorur pompë injeksioni një komponentëshe, si Aliva AL-1200, AL-1250 ose me Sika [®] Hand Pump. Portat e injektimit (pipëzat) vendosen në interval pothuajse 25 cm të gjatësisë së plasaritjes. Plasaritja midis portave të injektimit (pipëzat) izolohet p.sh. me Sikadur [®] -31 për të parandaluar rrjedhjen e rrëshirës së injektuar gjatë procesit të injektimit. Plasaritjet vertikale duhet të injektohen gjithmonë nga poshtë lartë. Sapo rrëshira e injektuar të fillojë të rrjedhë jashtë pipëzës / portës së injektimit të rradhës, izolohet e para dhe procesi i injektimit vazhdon me pipëzen / portën tjetër. Pas përfundimit të procesit të injektimit, portat (pipëzat) e injektimit si dhe materiali izolues midis portave duhet të hiqen.
Mirëmbajtja e mjeteve	Largimi i mbetjeve të freskëta nga mjetet dhe pajisja e aplikimit mund të bëhet me ujë. Materiali i ngurtësuar dhe/ose i pjekur mund të hiqet vetëm mekanikisht.

Koha e punueshmërisë

Temperatura	Lloji Normal (përzierje 1 kg)	Lloji me Kohë punueshmërie të gjatë (përzierje 1 kg)
+5°C	~ 120 minuta	-
+10°C	~ 80 minuta	-
+23°C	~ 25 minuta	~ 70 minuta
+30°C	~ 10 minuta	~ 30 minuta
+40°C	-	~ 10 minuta

Shenime mbi aplikimin / Kufizime

Gjërësia maksimale e plasaritjeve për injektim: 5 mm.

Sikadur®-52 Injection Lloji N dhe Lloji LP janë të përshtatshme për kushte të thata dhe me lagështi, por jo për injektime në kushte të lagura.

Baza e vlerave të matshme

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

Kufizime lokale

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për përshkrimin e saktë të fushave të aplikimit.

Informacione mbi shëndetin dhe sigurinë

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit të sigurt, maganizimit dhe asgjësimit të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen botimit më të fundit të fletës me të dhënat e sigurisë (Safety Data Sheet, SDS), e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike, etj. rreth sigurisë gjatë përdorimit të produktit.

Shënime ligjore

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të SIKA-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e SIKA-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj formë tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. SIKA ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas të gjitha kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit.



Sika Albania SHPK
 Rruga Ibrahim Rugova,
 Sky Tower, Building no. 5,
 9th floor, Office 91,
 Tirana, Albania.

Tel.: +355 4 454 0070
 Email: info@al.sika.com
 alb.sika.com